

Të nderuar kujdestarë të shkollave publike (PS Caregivers)_____,

Jemi të entuziazmuar t'ju njoftojmë se këtë vit shkollor, ju do të keni mundësinë të ndiqni udhëtimin e fëmijës suaj me autobus nëpërmjet një aplikacioni për telefonat inteligjentë ose ueb sajt.

Për t'u futur në aplikacion ose në aplikacionin ueb, do t'ju nevojiten të dhënat e hyrjes për llogarinë tuaj të shkollave të qytetit të Nju Jorkut (NYCSA) - nëse keni nevojë për ndihmë për të hyrë në llogarinë tuaj të NYCSA, ju lutemi t'i drejtoheni_____

Aplikacioni i shkollës së qytetit të Nju Jorkut (NYC School Bus App) është risia më e fundit në kuadër të nismës shumëvjeçare të shkollave publike të qytetit të Nju Jorkut (NYC Public Schools) për të modernizuar sistemin e transportit shkollor të qytetit të Nju Jorkut (NYC). Jemi të kënaqur që tani mund të ofrojmë transparencë më të madhe për transportin e nxënësve për kujdestarët dhe shkollat, si dhe të përmirësojmë efikasitetin e shërbimit të transportit me autobusë.

Udhëzimet për shkarkimin dhe përdorimin e aplikacionit mund t'i gjeni në schools.nyc.gov/SchoolBusApp. Nëse keni pyetje në lidhje me aplikacionin ose dëshironi të na jepni përshtypjet tuaja, ju lutemi t'i drejtoheni_____


dhe ata do ju mbështesin!

Jemi të entuziazmuar për vënien në dispozicion të këtij shërbimi.

Në bashkëpunim,
Ekipi i projektit për autobusë të shkollës
së qytetit të Nju Jorkut

schools.nyc.gov

   /nycschools



Skanoni për të
shkarkuar aplikacionin
NYC School Bus app.